



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**Ae.nr.259/2019**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“N...”] me seli ne Wien, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [A.D], avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [L.B], avokat nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, ekzekutim i garancionit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.212/2017, dt.18.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.09.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e të paditurit Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr. 212/2017, dt.18.06.2019.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar V.EK.nr. 212/2017, dt.18.06.2019, e ka aprovuar ne tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses [“N...”], me seli ne Wien dhe është detyruar e paditura kompania e sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë, që në emër të ekzekutimit të sigurimit të garancionit – kontratës nr. ..., të datës 04.12.2015 t’ia paguaj paditëses shumën e mjeteve në lartësi prej 285,376.70€ me kamatë në lartësi prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit nen kërcënimin e përmbarimit me dhune, si dhe është detyruar e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 7,450.00€ të gjitha këto ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nen kërcënimin e përmbarimit me dhune.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkak konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoje, aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse me propozimin që të refuzohet në tërësi ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimin V.EK.nr.212/2017, dt.18.06.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të LPK-së dhe vlerësimit të shkresave tjera lëndore, ka gjetur se:

**Ankesa është e palejuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se lënda në fjalë sipas ankesës së ushtruar nga i padituri në Gjykatën e Apelit është pranuar më datën 16.07.2019. Para se kjo gjykatë të shqyrtonte dhe të vendoste në mënyrë meritore lidhur me ankesën e të paditurit, i padituri më parashtrësën e datës 14.08.2020 Gjykatën e Apelit e ka njoftuar se ka tërhequr ankesën të cilën e kishte paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, V.EK.nr. 212/2017, dt.18.06.2019, me arsyetim se palët lidhur me çështjen në fjalë kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore. Se bashku më këtë parashtrësë i padituri ka bashkangjitur parashtrësën e datës 14.08.2020 më të cilën kishte bërë tërheqjen e ankesës.

Me dispozitën e nenit 186 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se: *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”* ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet se: *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186”.*

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të parashtrësës së të paditurit më të cilën qartë është deklaruar për tërheqjen e ankesës së ushtruar, në kuptim të dispozitës së nenit 177.2 të LPK-së ku theksohet se *“Deri në momentin e dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë pala mund ta tërheqë ankesën e paraqitur”* gjeti se ankesa është e palejuar, dhe si e tillë duhet hedhur poshtë.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të parashtrësës së të paditurit më të cilën qartë është deklaruar rreth tërheqjes së ankesës së ushtruar, kjo gjykatë në kuptim të dispozitës së nenit 186 paragrafi 3 i LPK-së, gjeti se ankesa e paraqitur nga i padituri është e palejuar, dhe si e tillë në mbështetje të nenit 196 të te njëjtit ligj, duhet hedhur poshtë.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata e Apelit e Kosovës, vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në pajtim me nenin 186 paragrafi 3, 195 paragrafi 1 pika (a) e lidhur me nenin 196 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ae.nr.259/2019, me datë 07.09.2020**

**GJYQTARI**  
*Mahir Tutuli d.v.*

